VENDIM
Nr. 110, datë 10.2.2016

PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. FADIL CANAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", dhe në vijim të shkronjës "c", të pikës 9, të vendimit nr. 33, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Fadil Canaj, në masën 1 059 800 (një milion e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësinë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama